



|   |                               |                               |                               |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Punëheno / Prodato<br>Received / Delivery | 15. 09 2022                   | 2                             | viti<br>god<br>year           |
| Organ / Njësia<br>Org / Jedinica<br>Org / Unit                  | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKIMSHICA   | 5923/2022                     |                               | 1/3                           |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.683/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.683/2022 të datës 02.08.2022 të parashtruar nga ankuesja

Prishtinë kundër organit të punësimit Sekretariatit të Këshillit Prokurorial i Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.683/2022, e datës 02.08.2022, e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në Fuqi Vendimi numër protokolli KA. Nr.23/2022 i datës 04.07.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën "Zyrtare e Lartë për Statistika", në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datë 02.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 4473/2022, kundër Vendimit me numër protokolli KA.Nr. 23/2022 të datës 04.07.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.08.2022 ankesën e ankueses e ka dërguar për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli, me datë 18.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 4781/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 4473/2022 të datës 02.08.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për harmonizimin e koeficientit me numër 828 i datës 19.05.2022; Vendim me numër protokoll KA.Nr. 23/2022 të datës 04.07.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendim me nr.92/2012 i datës 17.05.2012; Kontratë e Punësimit e F.R. i datës 01.10.2011; Akt Emërim i F.U. me numër protokoll ZBNj/DP-056-2013 i datës 01.07.2013; Përgjigje në kërkesë me numër 916/2022 i datës 01.06.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 08.08.2022; Përgjigje në ankesë i datës 18.08.2022; Ankesë drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër 1103 i datës 27.06.2022; Lista e pagave për muajin korrik 2022; Përshkrimi i Detyrave të Punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Bazën e të Dhënave; Përshkrimi i Detyrave të Punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Statistika; Pliko me numër 1397 i datës 18.08.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] **është e pazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar të ankuesja [redacted] është e punësuar në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pozitën "Zyrtare e Lartë për Statistika" me koeficient dhjetë (10). Ankuesja më datë 19.05.2022 me numër protokoll 828 ka bërë kërkesë për harmonizimin e koeficientit tek U.D. Drejtori i Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa Menaxherja e Personelit me datë 01.06.2022 me numër protokoll 916/2022 i është përgjigjë lidhur me kërkesën për harmonizim të koeficientit të cilën e ka njoftuar se janë në proces të riorganizimit të brendshëm dhe sistematizimit të administratës në sistemin Prokurorial të Kosovës.

Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen e datës 01.06.2022 me numër protokoll 916/2022, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1103 me datë 27.06.2022 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës me pretendimin që ti bëhet harmonizimi i koeficientit nga dhjetë (10) në trembëdhjetë (13) dhe kompensim të diferencës së pagës në mënyrë retroaktive. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës ka nxjerr vendim me numër KA.Nr.23/2022 me datë 04.07.2022 me të cilin ka Hedhë poshtë si e pasafatshme ankesën e ushtruar nga ankuesja.

Ankuesja brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër Vendimit me numër protokoll KA.Nr. 23/2022 të datës 04.07.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. E njëjta pretendon se ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se bazuar në Vendimit me numër 92/2012 të datës 17.05.2012 të Këshillit Prokurorial të Kosovës është bërë harmonizimi i pagave të stafit të Sekretariatit ZKPSH-së dhe KPK-së me ato të Sekretariatit të KGJK-së, me këtë vendim është harmonizuar koeficienti nga tetë (8) në dhjetë (10) edhe për pozitën që mbanë ankuesja dhe në bazë të këtij vendimi i është ofruar për nënshkrim akt emërimi për pozitën "Zyrtare e Lartë për Statistika" me numër protokoll ZBNj/DP-056-2013 i datës 01.07.2013 të cilin e ka nënshkruar pa vërejtje. Po ashtu Kolegji, lidhur me pretendimin ankueses ka konstatuar se e njëjta nuk ka përshkrim të njëjtë të detyrave të punës me pozitën "Zyrtar i Lartë për Baza të të Dhënave" me të cilin ka kërkuar të harmonizohet koeficienti dhe i njëjti është i pazuar.

Meqenëse ankueses në vitin 2012 i është bërë ndryshimi i koeficientit nga tetë (8) në dhjetë (10) dhe e njëjta ka nënshkrua akt emërimit pa ndonjë vërejtje, atëherë çdo përpjekje për tentim të rritjes së koeficientit në raport me pozitat e tjera është jashtë afatshme në kuptim të nenit 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton që ankuesja nga viti 2013 nëse ka qenë e pakënaqur nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridike për të parashtruar ankesë në organet përkatëse, andaj parashtrimi i ankesës në vitin 2022 është në kundërshtim e me afatet ligjore, kështu që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.Nr.23/2022 të datës 04.07.2022 me të cilin ka hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën e ankueses, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda A.nr.683/2022**

Çlirim ZEKA  
*Çlirim*  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesen
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-

